



VENDIM
Nr.60 Datë 08.09.2010
PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË
“ANSARA KONÇESION” SH.P.K.

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.09.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ANSARA KONÇESION” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me liçensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1)
- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)
- Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3)
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4)

Mungesa e Dokumentacionit që ka të bëjë me paraqitjen e Lejes së përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike dhe Lejes Mjedisore nga organet përkatëse janë në proces përfundimi. (neni 9 pika 4.1.5, gërmat “b” dhe “c”).

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për liçensë të shoqërisë “ANSARA KONÇESION” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Labinot – Mal - Elbasan”.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve

-
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

K y vendim hyn në fuqi menjëherë.
K y vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA

Adresa: Blvd "Gjergj Fishta" Nr.10
963
Tirane
69 590
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

www.ere.gov.al